



Republika Kosovo
Republika e Kosoves
Republic of Kosovo

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГУТ
PRIJEMNA KANCELARIJA ZYRA E PRANIMIT
Org. jedi /Nt. org./Org. unit 0.2
Br. s./Nr.f./No.p./ 02-085/ 2022
Datim/Data/Date 30.06.2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 17 pika (s), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 8 pika (p), neni 15, paragrafi 15.1 të Statutit të Komunës së Ranillugut nr.02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në seancën e mbajtur më 30.06.2022 ka miratuar:

V E N D I M I N M B I
ZBATIMIN E PUNËVE TË KORRJEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
RNILLUGUT PËR VITIN 2022

1.

Propozimi kaloi në shqyrtimin kryesor në seancën seancën e katërt të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut të mbajtur më 30.06.2022, ku u lejua dhe u miratua me shumicë votash.

2.

Me miratimin e këtij vendimi, përcaktohen kushtet dhe kriteret bazë për realizimin e punimeve të korrjeve, si dhe formimi i Komisionit për monitorimin dhe vlerësimin e punimeve të vjeljes në territorin e Komunës së Ranillugut për vitin 2022, në përputhje me Rregulloren për realizimin e punëve korrjetare në territorin e Komunës së Ranillugut nr.02-052/2011 me të cilin përcaktohet çmimi, kërkesat për autokombajna, plotësimi i kërkesave për autokombajna dhe detyra e Komisionit.

3.

Komisioni për Monitorimin dhe Vlerësimin e Punëve të korrjes në Komunën e Ranillugut do të formohet në këtë përbërje:

1. Negovan Antiq - Kryetar i Komisionit.
2. Goran Artonovic-anëtar.
3. Aleksandar Stojanoviq – anëtar.
4. Bojan Jevtiq-anëtar.

4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Departamenti për Bujqësi dhe Pylltari dhe Komisioni për Monitorimin dhe Vlerësimin e Punëve të Korrjes në Komunën e Ranillugut.

5.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës.

Data: 30.06.2022

Ranillug

Përktheu: Lazim Bajrami



Kryesuesi i K.K të Ranillugut

Ivan Krstiq